

Ali Musliu, PhD¹

UDC:
341.231.14-44.325

**E DREJTA PËR SOLIDARITET:
PËRPJEKJE PËR ANALIZË KONCEPTUALE**

**ПРАВО НА СОЛИДАРНОСТ:
НАПОР ЗА КОНЦЕПТУАЛНА АНАЛИЗА**

**SOLIDARITY RIGHTS:
CONCEPTUAL ANALYSIS APPROACH**

Abstract

Although no third covenant on human rights was under consideration until 1981, several new human rights, such as the rights to development, to a healthy environment, and to peace, were already beginning to emerge in international law. These rights are known as the rights of third generation. The first generation of human rights included primarily those defined in the International Covenant on Civil and Political Rights (ICCPR). The second generation consisted mainly of the human rights specified in the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights (ICESCR). These three generation of human rights corresponded respectively to the three ideals (liberty, equality and fraternity) proclaimed during the period of enlightenment in Europe. Therefore, these new human rights should be thought of as solidarity rights. The paper reflects upon the emergence of human right to development, to a healthy environment, and to peace in international law. The article gives a critical assessment of the conception of solidarity rights and to consider whether they do, or should be a part of international human rights law.

¹ Profesor në Universitetin e Tetovës - Fakulteti Juridik, Maqedoni, Tetovë (ali.musliu@unite.edu.mk)

Keywords: Human Rights, Solidarity, International Law, Development, Peace, Environment

1. E drejta për paqe dhe siguri ndërkombëtare

E drejta për paqe dhe siguri ndërkombëtare thekson bazën e të drejtës ndërkombëtare publike, ku paraqitet parimi i ndalimit të luftës dhe përdorimit të mjeteve të dhunshme në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Tmerri i dy Luftërave Botërore, e detyroi njerëzimin që në nivel ndërkombëtar të ndërmarr hapa konkrete për sigurimin e të drejtave të njeriut dhe paqes ndërkombëtare. Me këtë qëllim u themelua Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe u miratua Karta e Kombeve të Bashkuara, e nënshkruar më 26 qershor 1945 në San Francisko.²

Në fillim të Kartës së OKB, në Preambulën e saj potencohen synimet themelore për paqe dhe siguri, si: “Të ruajmë brezat e ardhshëm nga murtaja e luftës, që dy herë gjatë një jete njeriu i ka shkaktuar njerëzimit vuajtje të papërshkrueshme, të shpallim përsëri besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e personalitetit të tij, në barazinë e të drejtave midis burrit dhe gruas si edhe midis kombeve të mëdha e të vogla, të krijojmë kushtet e domosdoshme për ruajtjen e drejtësisë dhe respektimin e detyrimeve të lindura nga traktatet dhe burimet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, të nxisim përparimin shoqëror dhe të krijojmë kushte jetese më të mira në liri më të madhe”.³

Paqja si koncept politik gjen reflektimin e saj në pothuajse të gjitha instrumentet ndërkombëtare dhe në politikat e deklaruara të shteteve. Koncepti i paqes si e drejtë për të gjithë popujt është shumë i diskutueshëm, duke qenë se ky i fundit bie ndesh me të drejtën e përdorimit të forcës me qëllim vetëmbrojtjen, të parashikuar nga e drejta ndërkombëtare.

Instrumenti i parë ndërkombëtar që vetëm përcaktoi në mënyrë të tërthortë të drejtën në paqe është Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Deklarata në nenin 28 përcakton të drejtën, që: “Secili ka të

² Karta e Kombeve të Bashkuara u miratua në fund të punimeve të Konferencës së OKB-së, dhe hyri në fuqi më 24 tetor të vitit 1945.

³ Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press, f. 12.

drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë”.⁴

Më tutje, kjo e drejtë është përpunuar dhe formuluar në Deklaratën e Popujve për Paqe të vitit 1984.⁵ Sipas Deklaratës, e drejta në paqe buron nga qëllimi i krijimit të OKB-së, parimet e të Drejtës Ndërkombëtare të përcaktuara në Kartën e OKB-së, vullneti i të gjithë popujve për të zhdukur luftën nga njerëzimi dhe për të shmangur një katastrofë nukleare mbarëbotërore. Deklarata gjithashtu thekson që vendosja e një paqe të qëndrueshme në botë, paraqet kusht themelor për ruajtjen e civilizimit njerëzorë dhe mbijetesës së njeriut në këtë kohë nukleare.⁶

Deklarata e njeh të drejtën themelore për paqe për të gjithë popujt e planetit.⁷ Garantim i kësaj të drejte, përbën një detyrim themelor për çdo shtet dhe, veç të tjerash, ajo nënkupton marrjen e masave nga ana e shtetit për të zhdukur kërcënimin e luftës, veçanërisht ndaj asaj nukleare dhe heqjen dorë nga përdorimi i forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare me mjete paqësore.⁸

Vlen të potencojmë edhe Deklaratën për Përdorimin e Progresit Shkencor dhe Teknologjik në Interes të Paqes dhe në Përfitim të Njerëzimit.⁹ Në këtë Deklaratë theksohet detyrimi i shteteve që të sigurojnë që progresi i shkencës dhe teknologjisë të përdoret në interes të forcimit të paqes dhe sigurisë në botë, si dhe shtetet janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që ky progres të mos kufizohet.¹⁰

⁴ Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, si një instrument mjaft të rëndësishëm për sigurimin e të drejtave të njeriut dhe sigurisë në botë.

⁵ Deklarata e Popujve për Paqe është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 39/11 të 12 nëntorit të vitit 1984. Deklarata në gjuhën angleze në dispozicion: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RightOfPeoplesToPeace.aspx>

⁶ UNESCO, SYMPOSIUM ON THE STUDY OF NEW HUMAN RIGHTS “THE RIGHTS OF SOLIDARITY”, Section II – “The Right to Peace”, Mexico, 12-15 August 1980.

⁷ Neni 1 i Deklaratës së Popujve për Paqe.

⁸ Neni 2, 3 dhe 4, e Deklaratës së Popujve për Paqe.

⁹ Deklaratën për Përdorimin e Progresit Shkencor dhe Teknologjik në Interes të Paqes dhe në Përfitim të Njerëzimit është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 3384 (XXX), të 10 nëntorit të vitit 1975.

¹⁰ Neni 2 dhe 3 i Deklaratës për Përdorimin e Progresit Shkencor dhe Teknologjik në Interes të Paqes dhe në Përfitim të Njerëzimit.

Sido që të jetë, në kushte të një realiteti të hidhur, kjo e drejtë më së shumti duket si një utopi se sa një e drejtë reale e proklamuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. E drejta për zhvillim

Zhvillimi i kësaj të drejte ka si bazë Kartën e OKB-së, në të cilën përshkruhet që shtet me qëllim zhvillimin e marrëdhënieve paqësore dhe miqësore ndërmjet tyre, ndër të tjera duhet të promovojnë progresin lidhur me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si dhe zhvillimin.¹¹

Dokument tjetër i rëndësishëm që lidhet me të drejtën për zhvillim është Deklarata për të Drejtën e Zhvillimit të OKB-së (1984),¹² që thekson se qenia njerëzore është një subjekt qendror i zhvillimit dhe duhet të marrë pjesë aktive dhe të përfitojë nga e drejta e zhvillimit. Deklarata parashihet përgjegjësinë për zhvillim në mënyrë individuale dhe kolektive, duke pasur parasysh respektin e të drejtave dhe lirive themelore si dhe detyrimeve ndaj komunitetit. Shtetet kanë të drejtën dhe detyrimin për të formuluar politikat e zhvillimit kombëtar që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së të gjithë popullsisë dhe të gjithë individëve mbi bazën e pjesëmarrjes aktive dhe të lirë në zhvillimin dhe në shpërndarjen e të drejtë të përfitimeve që rrjedhin prej saj.¹³

Dokument tjetër i rëndësishëm është Deklarata për Progresin Social dhe Zhvillim e miratuar në kuadër të OKB-së (1969).¹⁴ Deklarata

¹¹ Karta e OKB-së, Kapitulli IX: Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën ekonomike dhe sociale, Neni 55 - Për të krijuar atë gjendje stabiliteti dhe mirëqenieje, që është e nevojshme në mënyrë që mes kombeve të mbizotërojnë marrëdhënie paqësore dhe miqësore, të cilat bazohen në respektimin e parimeve të barazisë dhe të vetëvendosjes, Kombet e Bashkuara mbështesin: a) përmirësimin e standardeve të jetesës, punësimin e plotë dhe krijimin e kushteve për progres dhe rritje ekonomike e sociale; b) zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të ngjashme me to si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e kulturës dhe edukimit; c) respektimin e përgjithshëm dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, gjuhe dhe besimi fetar.

¹² Deklarata për të Drejtën e Zhvillimit, është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 41/128, sesionit plenar të 97-të, më 4 dhjetorit të vitit 1986.

¹³ Neni 2, 3 dhe 4, e Deklaratës për të Drejtën e Zhvillimit. (1986).

¹⁴ Deklarata për Progresin Social dhe Zhvillim, është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 2542 (XXIV), më 11 dhjetorit të vitit 1969.

thekson se: “Të gjithë popujt dhe qeniet njerëzore, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi, kombësia, origjina etnike, statusi familjar ose social, ose dënimi politik, ose çdo dënimi tjetër, kanë të drejtë për të jetuar me dinjitet dhe liri dhe të gëzojnë frytet e progresit social dhe duhet të kontribuojnë për të”.¹⁵

E drejta për zhvillim nënkupton jo vetëm barazinë e mundësive ndërmjet individëve, por edhe ndërmjet shteteve lidhur me përdorimin e burimeve themelore, arsim, shërbime shëndetësore, ushqim, strehim, punësim dhe shpërndarje të drejtë të burimeve dhe të ardhurave ndërmjet vendeve të botës. E drejta për zhvillim, në esencë nënkupton mbi të gjitha, një zhvillim të qëndrueshëm në harmoni të vazhdueshëm me natyrën dhe ligjet e saj. Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë një zhvillim i cili mundëson plotësimin e nevojave për brezin e tanishëm, pa cenuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Në këtë aspekt, e drejta për zhvillim lidhet ngushtë me të drejtën në ambient të pastër jetësor, pasi një zhvillim jo i qëndrueshëm do të cenonte ekuilibrat mjedisor në tokë.

Kjo e drejtë, në pjesën e të drejtave për solidaritet, është më tepër e kontestuar për arsyen se individi mundet vetëm në mënyrë të tërthortë të jetë bartës i kësaj të drejte. Në anën tjetër, situata ekonomike ndërkombëtare në botë është alarmante. Dallimet në mes vendeve të varfët dhe të pasur thellohet dita ditës.

3. E drejta në ambient të pastër jetësor

E drejta në ambient të pastër jetësor përbën një problem të rëndësishëm jetësor. Në dallim nga kohët e lashta, kur grupet e njerëzve jetonin të ndara, dhe kur çka do që ndodhte, godiste vetëm një grup, një kulturë, një hapësirë të kufizuar. Sot çfarëdo veprim i pamatur ndaj mjedisit nuk reflekton vetëm në afërsinë e drejtpërdrejtë, në një grup të kufizuar ose në brezin tonë, por reflektohet shumë më larg dhe u kanoset edhe brezave të ardhshëm.

Duke u nisur nga nevoja për një bashkëpunim ndërkombëtar për ruajtjen e mjedisit jetësor, u morën veprime konkrete për arsye se, “mjedisi jetësor konsiderohet res omnium, trashëgimi e përbashkët e njerëzimit”,¹⁶ prandaj si të tillë ajri, uji, deti etj., duhet ruajtur në të gjitha pjesët e botës dhe për të gjitha brezat. Gjithashtu, problemi i

¹⁵ Neni 1 i Deklaratës për Progresin Social dhe Zhvillim.

¹⁶ Gruda, Z. (2002). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f. 389.

ruajtjes dhe i përparimit të mjedisit jetësor shtrohet si problem gjithënjëzësor, ngase asnjë vend veç e veç nuk ka sistem të pavarur ekologjik. Materiet e dëmshme dhe efektet e tyre nuk godasin vetëm në rretë të kufizuar në afërsi të drejtpërdrejtë, por përhapen dhe veprojnë shumë më gjerë duke i kaluar kufijtë gjeopolitikë.

Duke u nisur nga kjo, akti përfundimtar i Konferencës Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim, në pjesë më të madhe që i referohet mjedisit jetësor të njeriut; mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor; si dhe mbrojtjen e natyrës dhe shfrytëzimin racional të pasurive natyrore i shpall si çështje të interesit të brezave të sotëm e të ardhshëm, ndërsa për suksesin e politikës në fushën e mjedisit të njeriut, duhet të kontribuojnë që të gjitha kategoritë e popullsisë dhe të gjitha forcat shoqërore.¹⁷

E drejta për një mjedis të shëndetshëm jetësor përmendet në nenin 12/2 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në kuadër të drejtës për shëndet. Në pikën (b) theksohet se: “Shtetet palë të Paktit, me qëllim realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet të ndërmarrin, ndër të tjera, edhe masa që synojnë përmirësimin e të gjitha aspekteve mjedisore dhe të higjienës industriale”.¹⁸

Për mjedisin jetësor dhe mbrojtjen ndërkombëtare të saj, me rëndësi është të përmendim Konferencën e Stokholmit. Kjo konferencë është mbajtur prej 5 deri më 16 qershor, ku merrnin pjesë mbi 1.200 delegatë nga 110 vende të botës dhe përfaqësues institucioneve të specializuara, të organeve të Kombeve të Bashkuara dhe të përfaqësuesve të shumë organizatave ndërkombëtare qeveritare ose joqeveritare. Në fund të punimeve të veta Konferenca ka aprovuar: Deklaratën mbi

¹⁷ Akti përfundimtar i Konferencës Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim, Helsinki 1975.

¹⁸ PNDESK, Neni 12, 1. Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë. 2. Masat që shtetet palë të këtij Pakti do t'i marrin për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte duhet t'i përfshijnë ato masa që janë të nevojshme për të siguruar: (a) Uljen e vdekshmërisë gjatë lindjes dhe vdekshmërisë së foshnjave, si dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës; (b) Përmirësimin e të gjitha aspekteve të higjienës së mjedisit dhe të higjienës industriale; (c) Parandalimin, mjekimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe të sëmundjeve të tjera; (ç) Krijimin e kushteve të cilat do të siguronin shërbime mjekësore dhe ndihmë mjekësore për të gjithë në rast sëmundjeje.

mjedisin e njeriut; Planin Aksional me 109 rekomandime, si edhe një rezolutë mbi marrëveshjet institucionale lidhur me mjedisin jetësor.¹⁹

Dy konferenca tjetra të radhës që ka ndikuar dukshëm në zhvillimin e kësaj të drejte janë ato të Rio de Zhaneiro në Brazil. Konferenca e parë e OKB-së për Mjedisin dhe Zhvillimin e saj është mbajtur në qershor të vitit 1992, e njohur edhe si Samiti për Tokën, ndërsa e dyta pas 20 viteve në qershor të vitit 2012, e quajtur Rio + 20, ose Rio Samiti i Tokës. Në fund të punimeve Konferenca ka miratuar: Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillim; Agjendën 21; Parimet mbi Pyllin etj.

E drejta për ambient të pastër jetësor, tani më është pjesë e shumë traktateve të cilat jo vetëm që njohin atë, por edhe përcaktojnë masat për realizim e kësaj të drejte. Traktatet më të rëndësishme janë: Konventa për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjes së egër në hemisferën perëndimore (1940); Konventa mbi tregtinë e specieve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër (1974); Konventa për Trashëgimi Botërore (1972); Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Ozonit (1987); Protokollin e Montrealit për Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit (1987); Konventa e Baselit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbeturave të Rrezikshme dhe Trajtimit të Tyre (1989); Konventa për Ndryshime Klimatike (1992); Protokollin e Kyotos që ndryshon Konventën Kuadër (1997); Konventa për Biodiversitetin Biologjik (1992) etj.²⁰

Sot, mbrojtja dhe avancimi i ambientit jetësor paraqet një kërkesë të patjetërsueshme mbarë njerëzore, pasi procesi i dëmtimit të baraspeshës natyrore, në shumicën e rasteve është një proces ireverzibil dhe shërben si shkas për përballje me shumë katastrofa natyrore nga të cilat njerëzimi është i pambrojtur.

Përfundim

Për realizimin e të drejtave të gjeneratës së parë dhe të dytë të njeriut, doemos nevojitet realizimi i një të drejte solidare në të drejtën ndërkombëtare. Kjo padyshim që paraqet njohjen e obligimeve të përbashkëta të shteteve dhe zgjerimin e detyrimeve përtej entiteteve të shteteve. Shtetet duhet të njohin më shumë ndërvarësinë të tyre globale, ku sjellja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, tejkalojnë kufijtë

¹⁹ Gruda, Z. (2002). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f. 392.

²⁰ Më tepër lidhur me dokumentet ndërkombëtare që mbrojnë ambientin jetësor shih në: Gruda, Z. (2002). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, f. 389-411.

nacionalë dhe paraqiten si trashëgimi e përbashkët e njerëzimit. Këto të drejta nuk mund të realizohen pa një të drejtë solidarë të shteteve në paqe, zhvillim dhe ambient të pastër. Meqë këto të drejta paraqiten si trashëgimi e përbashkët e njerëzimit, ato tejkalojnë kufijtë nacionalë. Në fillim të shekullit XXI, bota po kalon sfidën më të madhe pas periudhës së rënies së komunizmit (luftërat në Siri dhe Irak), veçanërisht me një qasje të re politike të administratës amerikane. Bashkësia ndërkombëtare duhet të ngritë përpjekjen që të prezanton dhe në mënyrë efektive implementon të drejtën për solidaritet si pjesë e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Conclusion

The realization and security of first and second generation rights of individual human beings requires the introduction of greater solidarity into international law. This certainly includes the recognition of some joint obligations of all states and some broadening of duty bearers beyond states. As states come to recognize more fully their global interdependence, they may come to act so that the emergence of a few group rights of people would also advance the cause of human rights. In the beginning of XXI century, world faces the biggest challenge after the fall of communism (wars in Syria and Iraq), especially with the new political approach of the US administration. International community should raise the effort to introduce and effectively implement solidarity rights in international human rights law.

Recensentë

Prof. dr. Bajram Pollozhani

Prof. dr. Afrim Osmani

5. Literatura

- Alfredsson, G., & Eide, A. (1999). *The Universal Declaration of Human Rights – A Common Standards of Achievement*. Martinus Nijhoff Publishers;
- Akti përfundimtar i Konferencës Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim, Helsinki 1975.
- Baxi, U. (2001). *The future of human rights*. New York: Oxford University Press;

- Beck, U. (2000). *What is globalization?* Cambridge: Polity Press;
- Brownlie, I. (2009). *Basic Documents in International Law*. Oxford University Press, fq. 12.
- Halpin, A. (1994). New Rights for Old? *The Cambridge Law Journal*, 53(3), 573-595.
- Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
 - Deklarata e Popujve për Paqe është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 39/11 të 12 nëntorit të vitit 1984. Deklarata në gjuhën angleze në dispozicion: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RightOfPeoplesToPeace.aspx>
- Deklaratën për Përdorimin e Progresit Shkencor dhe Teknologjik në Interes të Paqes dhe në Përfitim të Njerëzimit është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 3384 (XXX), të 10 nëntorit të vitit 1975.
- Deklarata për të Drejtën e Zhvillimi, është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 41/128, sesionit plenarë të 97-të, më 4 dhjetorit të vitit 1986.
- Deklarata për Progresin Social dhe Zhvillim, është e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me anë të Rezolutës 2542 (XXIV), më 11 dhjetorit të vitit 1969.
- UNESCO, SYMPOSIUM ON THE STUDY OF NEW HUMAN RIGHTS “THE RIGHTS OF SOLIDARITY”, Section II – “The Right to Peace”, Mexico, 12-15 August 1980.
- Karta e Kombeve të Bashkuara u miratua në fund të punimeve të Konferencës së OKB-së, dhe hyri në fuqi më 24 tetor të vitit 1945.
- LAMBERT, R. (1996). Regional solidarity and union rights. *International Union Rights*, 3(2), 6-7.
- Leib, L. (2011). AN OVERVIEW OF THE CHARACTERISTICS AND CONTROVERSIES OF HUMAN RIGHTS. In *Human Rights and the Environment: Philosophical, Theoretical and Legal Perspectives* (pp. 41-68). LEIDEN; BOSTON:
- MARINO, J. (1995). *Global solidarity*. *International Union Rights*, 2(1), 6-6.

- Musliu, A. (2018). *Të drejtat e njeriut*. Albiz Fondacioni. Shkup
- Gruda, Z. (2002). *E drejta ndërkombëtare publike*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, fq. 389.
- Wellman, C. (2000). Solidarity, the Individual and Human Rights. *Human Rights Quarterly*, 22(3), 639-657.
- Zieck, M. (1992). The Concept of "Generations" of Human Rights and the Right to Benefit from the Common Heritage of Mankind with Reference to Extraterrestrial Realms. *Verfassung Und Recht in Übersee / Law and Politics in Africa, Asia and Latin America*, 25(2), 161-198.